



*Udhëzues i të drejtave për gratë
e juaja që arrijnë në Francë*



FRANCA ËSHTË REPUBLIKË E PANDASHME LAIKE,
DEMOKRATIKE E SOCIALE.

LIGJI GARANTON TRAJTIMË TË BARABARTË TË
INDIVIDËVE PA MARË PARASUSHË ORIGJINËN E TYRE,
BESIMIN FETAR, RASËN DHE GJININ.

FEMRAT E MASHKUJTË I KANË DREJTAT E BARABARTA :
ATA KANË TË NJËJTAT DREJTA NË KUADËR TË JETËS
SHOQËRORE, BASHKËSHORTORE, FAMILJARE DHE
PROFESIONALE.

LEJET (TITUJT) E QËNDRIMIT



•► HYRJA NË TERRITORIN FRANCEZ

Ju keni mbi 18 vjet dhe nuk jeni shtetas i një shteti të Bashkimit Evropian. Ju dëshironi të qëndroni në Francë. Ju duhet të merrni një vizë.

Aplikimet për vizë bëhen në Konsullatën ose Ambasadën Franceze e vendit ku banoni.

• Viza me qëndrim të shkurtër:

Viza për qëndrim të shkurtër ju lejon të qëndroni në Francë dhe vende të tjera të Shengenit. Është e vlefshme për një kohëzgjatje maksimale prej 90 ditësh. Kjo leje mund të jepet për udhëtime turistike, profesionale, një vizitë familjare ...

• Viza për qëndrim të gjatë:

Viza për qëndrim të gjatë (VLS) ju lejon të qëndroni në Francë për më shumë se 3 muaj. Ekzistojnë disa lloje viza për qëndrim të gjatë (VLS) sipas motivit të qëndrimit: VLS e cila vlen si titull qëndrimi, VLS që ka nevojë për një aplikimkartele për arsye familjare, punë, pension dhe VLS të veçantë (studentë, artistë, vizitorë, të rinj).

Bashkëshort francez : Ju mund të aplikoni për një leje qëndrimi me qëndrim të gjatë si bashkëshort francez. Do të ketë një vlerë si titull qëndrimi. Ju duhet të plotësoni formalitetet në OFII brenda 3 muajsh nga arritja tuaj. Ju nuk keni procedura në Prefekturë gjatë vlefshmërisë së vizës.

• Bashkimi familjar:

Bashkimi familjar është një procedurë që ju lejon të sjellni në Francë bashkëshortin (bashkëshorten) tuaj dhe / ose fëmijët tuaj të mitur që banojnë në një vend të huaj jashtë Bashkimit Evropian.

Ju duhet të mbani një titull qëndrimi të vlefshme dhe të jeni të pranishëm në Francë në baza të rregullta për të paktën 18 muaj. Kërkesa bëhet në OFII.

• Nëse jeni viktimë e dhunës familjare ose familjare,

Prefekti mundet, nën kushte të caktuara, t'ju lëshoj ose vazhdoj titullin e qëndrimit.

•► QËNDRIMI NË FRANCË

Ka tituj qëndrimi të ndryshëm:

Titull qëndrimi të përkohshëm njëvjeçar, titull qëndrimi shumëvjeçar lëshuar për një periudhë prej 2 deri në 4 vjet, kartela rezidente e lëshuar për 10 vjet. Këto tituj mund të vazhdohen kur u skadon afati. Kërkesa për titull qëndrimi bëhet në Prefekturën e vendit ku banoni.

•► AZIL

Lufta për azil ju mundëson të fitoni statusin e refugjatit ose përfitimin e mbrojtjes plotësuese. Sipas Konventës së Gjenevës të vitit 1951, statusi i refugjatit i jepet.

« çdo personi i cili (...) ka një frikë të bazuar nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, grupit social apo mendimet e tija politike, është jashtë vendit ku ka kombësi dhe nuk mundet, ose për shkak të kësaj frike, të mos kërkojë mbrojtjen e këtij vendi ».

Për të paraqitur një lutje për azil, sapo të mbërrini në Francë, duhet të kontaktoni një shoqatë parimirëprirje (PADA) për t'u regjistruar në zyrën e vetme të pritjes për azilërkuesit në Prefekturë.

Një vërtetim i lutjes për azil do t'ju jepet dhe do t'ju lejojë të qëndroni në Francë për një muaj. Do t'ju jepet një formular për Zyrën franceze të emigracionit dhe integritit (OFII), për ta dërguar atë në Zyrën franceze për mbrojtjen e refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA) brenda 21 ditëve.

KONTAKTE TË DOBISHME

Préfecture de l'Eure : Boulevard Georges Chauvin, à Evreux : 02 32 78 27 27

Sous-préfectures :

3 rue de la Sous-Préfecture à Bernay : 02 32 46 76 87

10 rue de la Sous-Préfecture aux Andelys : 02 32 54 74 87

France terre d'asile : 11 Ter avenue du Château à Evreux : 02 32 23 10 25

Office français de l'immigration et de l'intégration (OFII) : 02 32 18 09 94

FAMILJA



► TRE FORMAT E BASHKIMIT NË FRANCË

• Martesa:

Akt juridik i bazuar në pajtimin e dy bashkëshortëve. Vetëm martesa civile është e njohur ligjërisht, prandaj duhet të ndërhyjë detyrimisht përpara një martese tradicionale ose fetare.

• Pakti Civil i Solidaritetit (PACS):

Kontratë e lidhur midis dy personave, të gjinisë të ndryshme ose të njëjtës gjini, për të organizuar jetën e tyre së bashku.

• Bashkëjetesa:

Një bashkim i zakonshëm, i cilësuar nga një jete në bashkësi të qëndrueshme midis dy personave të gjinisë së ndryshme ose të njëjtës gjini.

► NNDARJA NË FRANCË

Ashtu siç mund të vendosni lirisht të jetoni si çift, mund të vendosni ta përfundoni jetën e përbashkët. Pas ndarjes, ndihma mund t'ju caktohet (shih CAF).

• Nëse dëshironi të përfundoni martesën,

mund të kërkonti divorc. Disa procedura bëhen në

Gjykatë (Tribunal de grande instance) Asistenca e një avokati është e detyrueshme (ju mund të përfitonin nga ndihma juridike, nën disa kushte).

• Nëse dëshironi të përfundoni PACS-in,

duhet të dërgoni lutjen në komunë që ka bërë regjistrimin e deklaratës PACS ose tek notari që ka bërë regjistrimin e deklaratës PACS. Nëse partneri juaj nuk pajtohet, duhet të kontaktoni një nëpunës i Përmbarimi (huissier de justice).

• Përfundimi vullnetar i martesës nga njëri anëtar i çiftit nuk ekziston në ligjin francez.

► AUTORITETI PRINDËROR

Autoriteti prindëror është grup i të drejtave dhe detyrave të prindërve në lidhje me fëmijët e tyre, nën moshën 18 vjeçare. Ai ushtrohet bashkërisht dhe në mënyrë të barabartë nga të dy prindërit, qoftë të martuar apo jo, nëse jetojnë së bashku ose veç e veç (përveç rasteve të veçanta).

► RRËMBIMI NDËRKOMBËTAR OSE ZHVENDOSJA E PALIGJSHME E FËMIJËVE

Një prind nuk mund të vendosë vetë ta marrë fëmijën e tij për të jetuar në një qytet tjetër ose në një vend tjetër pa pajtimin e prindit tjetër ose të Gjyqtarit të Gjykatës së Familjes. Në rast kërcënimi mund të kontaktoni Policinë, Xhandarmërinë ose Prefekturën.

KONTAKTE TË DOBISHME

Centre d'information sur les droits des femmes et des familles de l'Eure (CIDFF) :
12 rue de l'Esperanto à Evreux,
02 32 33 44 56

Maison de la justice et du droit (MJD) :
A Evreux : 02 32 32 07 91
A Louviers : 03 32 40 96 60
A Pont-Audemer : 02 32 41 78 90
A Vernon : 02 32 71 28 10

Caisse d'allocations familiales (CAF)
de l'Eure : 0810 25 27 10

Office français de l'immigration et de l'intégration (OFII) : 02 32 18 09 94

PRAKTIKAT E

NDALUARA



► DHUNA

Dhuna - fizike, seksuale, morale, ekonomike ose psikologjike - e kryer sidomos nga bashkëshorti ose ish-bashkëshorti është ndaluar me ligj dhe autorët e tyre janë të dënuar ligjërisht.

Në rast urgjent, thirrni 17 (policia, xhandarmëria).
Për një dëgjim, telefononi 39 19.
Para se të largoheni nga shtëpia familjare, kontaktoni policinë ose xhandarmërinë

► MARTESA E DETYRUAR

Martesa ka nevojë për pajtimin e përbashkët të bashkëshortëve të ardhshëm. Nëse vërtetohet se një ose të dy bashkëshortët janë detyruar të martohen, martesa mund të anulohet dhe personat që kanë detyruar martesën mund të dënohen. Moshë ligjore për t'u martuar është 18 vjeçare.

Një urdhër mbrojtjeje mund të shqiptohet nga Gjyqtari i Gjykatës së Familjes në rast të një dhune të tillë (bashkëshortore, martesë të detyruar) me mundësinë e fshehjes së adresës së viktimës dhe ndalimit të agresorit të hyj në kontakt me të apo edhe fëmijët e tij (saj).

► GJYMTIMI GJENITAL FEMËROR

Çdo gjymtim i ushruar në organet gjenitale, sidomos prerja e organeve seksuale tek djemtë dhe vajzat, është i ndaluar. Në varësi të rëndësisë të akteve, dënimet mund të arrijnë 20 vjet burgim penal. Ligji francez zbatohet kur gjymtimi kryhet në Francë ose në një vend të huaj, nëse viktimë është franceze ose nëse është e huaj dhe zakonisht banon në Francë.

Në rast të kërcënimeve për martesë të detyruar ose gjymtim seksual ndaj të miturit, mund të shqiptohet ndalimi i daljes nga territori.

► POLIGAMIA

Në Francë, martesa e një burri me disa gra është e ndaluar, është një krim penalisht i dënuar. Një burrë nuk mund të martohet në territorin francez nëse ai tashmë ka një grua në vendin e tij të lindjes ose diku tjetër, pavarësisht nga kombësia e tij.

Dënimi është 1 vjet burg dhe 45 000 euro gjobë.

► MBULIMI I FYTYRËS

Askush nuk mundet, në hapësirën publike, të veshë një veshje që synon të fshehë plotësisht fytyrën e tij (ligji i tetorit 2010).

Dënimi është një gjobë deri në 150 euro. Gjobat rëndohen në rast të fshehjes me detyrim të fytyrës dhe dyfishohen nëse viktimë është e mitur.

KONTAKTE TË DOBISHME

Association d'aide aux victimes (AVEDE-ACJE) :
02 32 23 15 15

Centre d'information sur les droits des femmes et des familles de l'Eure (CIDFF) :
12 rue de l'Esperanto à Evreux : 02 32 33 44 56

Maison de la justice et du droit (MJD) :
A Evreux : 02 32 32 07 91
A Louviers : 03 32 40 96 60
A Pont-Audemer : 02 32 41 78 90
A Vernon : 02 32 71 28 10

Police, gendarmerie : 17

Groupe pour l'abolition des mutilations sexuelles (GAMS) :
01 43 48 10 87 ou 06 78 04 40 29

SHËNDETËSIA



► QASJA NË SHËRIM

Çdokush në territorin francez ka të drejtë të shërohet. Nëse jeni në një situatë të rregullt, keni të drejtë për një sigurim shëndetësor me një numër të sigurimit shëndetësor:

- ose sepse punoni,
- ose sepse jeni në Francë prej më shumë se 3 muaj

Në të gjitha rastet, kontaktoni Fondin e Sigurimit Shëndetësor Parësor (CPAM).

Çdokush në një situatë të parregullt dhe që jeton në Francë prej më shumë se 3 muaj mund të përfitojë nga sigurimi shëndetësor. Është Ndihma Mjekësore e Shtetit (AME). Për ta bërë këtë lutje, kontaktoni Fondin e Sigurimit Shëndetësor Parësor (CPAM) ose Qendrën e Qasjes në Shëndetësi në spital (PASS). Kushti për qëndrim prej 3 muajsh nuk zbatohet për të miturit, prindërit e të cilëve janë në një situatë të parregullt. Fondi i Sigurimit Shëndetësor Parësor (CPAM) lëshon një vërtetim të të drejtave ose një kartë vitale, ose një kartë pranimit për AME, për të paraqitur në kontrollë të mjeku ose në spital, në barnatore.

Me një vërtetim të të drejtave ose një kartë vitale, mund të aplikoni për analiza shëndetësore falas që do të zhvillohet në një Qendër Shqyrtimi Shëndetësor të CPAM (Centre d'Examens de Santé de la CPAM).

► KUNDËRNGJIZJE (KUNDËRPLENIM, KONTRACESION)

Kundërngjizje është grupi i metodave të përdorura për të parandaluar një shtatzëni që ju nuk dëshironi. Është një e drejtë ligjore që nga viti 1967.

Asnjë autorizim nga familja ose bashkëshorti nuk është i nevojshëm.

Për të zgjedhur metodën që ju përshtatet më së miri, mund të kontaktoni:

- një mjek i përgjithshëm,
- një gjinekolog dhe, sipas kushteve të caktuara, një motër medicinale për shtatzëni (sagefemme)
- një qendër të planifikimit familjar dhe kontrolla para lindjes që ofron kontrolla mjekësore falas dhe me karakter të fshehtë. Pa pagesë dhe anonimiteti janë të garantuar për të rriturit dhe të miturit.

Nëse jeni e mitur, nuk keni nevojë për leje prindërore për të përdor kundërngjizje.

► NDËRPRITJA VULLNETARE E SHTATZËNISË (IVG)

Ju jeni shtatzënë dhe nuk doni ta vazhdoni këtë shtatzëni, ju mund të vendosni për një ndërpritje vullnetare e shtatzënisë ose abort. Është një e drejtë ligjore. Asnjë autorizim nga familja ose bashkëshorti nuk është i nevojshëm.

Sa më shpejt që të jetë e mundur, kontaktoni një mjek (zyra mjekësore, qendër planifikimi, spital).

Një e mitur që nuk mund të flasë me prindërit e saj, duhet të shoqërohet nga një person në moshë madhore zgjedhur nga ajo.

Ndërpritja vullnetare e shtatzënisë duhet të kryhet para fundit të javës së 12-të të shtatzënisë.

► SHTATZËNIA DHE LINDJA

Mjeku ose motra medicinale për shtatzëni mund të deklaroj në internet shtatzëninë gjatë kontrollit të parë të shtatzënisë.

Ju do të merrni një udhëzues »Shtatzënia ime - unë përgatis arritjen e fëmijës tim«, një kalendar të kontrollave tuaja mjekësore dhe dokumente të tjera praktike që do t'ju shoqërojnë gjatë shtatzënisë.

Qendra e mbrojtjes së nënave dhe fëmijëve (PMI) organizon kontrolla për gratë shtatzëna dhe fëmijët nën 6 vjeç.

Caisse primaire d'assurance maladie (CPAM) :
36 46

Centre de planification :

Bernay : 02 32 45 63 11

Evreux : 02 32 39 15 00

Gisors : 02 32 27 78 93

Louviers : 02 32 25 75 66

Pont-Audemer : 02 32 42 88 99

Val De Reuil : 02 32 61 11 15

Verneuil Sur Avre : 02 32 23 62 16

Vernon : 02 32 71 66 48

KONTAKTE
TË DOBISHME

STREHIMI



Ju duhet të keni një banesë në çastin e lutjes, duke treguar sipërfaqen dhe të gjitha karakteristikat e banesës. Nëse plotësohen kushtet, bashkimi i familjes mund të lejohet.

Nëse bashkëshorti juaj është poligam dhe dëshironi të keni qasje në një strehim të veçantë, mund të ndihmoheni: informoheni pranë një asistent social (nga Këshilli i departamentit, nga CCAS i Qytetit).

➔ APLIKIMI PËR BANIM SOCIAL

Kushdo që ka leje qëndrimi të vlefshme që dëshiron të marrë strehim social duhet të aplikojë:

- ose në internet: www.demande-logement-social.gouv.fr
- ose duke dërguar një lutje tek një qiradhënës social (Office Public des HLM ose agjencitë e pasurive të paluajtshme sociale)

Situata juaj familjare dhe financiare merret parasysh për të përcaktuar nëse keni të drejtë për strehim social. Asnjë shpenzim nuk nevojitet kur aplikoni për strehim.

Ju mund të kërkonti këshilla nga një asistent social në Këshillin e departamentit, në CCAS të qytetit tuaj ose pranë referentit tuaj nëse jetoni në një qendër mirëpritjeje.

Nëse nuk keni strehim, ju mund të strehoheni përkohësisht ose për një kohëzgjatje të ndryshueshme. Informoheni pranë një asistent social në Këshillin e Departamentit ose CCAS në qytetin tuaj.

Në rast urgjent që kërkon strehim, thirrni 115 (numrin e telefonit falas gjatë 24 orësh).

➔ SITUATA TË TJERA

Në kuadër të një lutje për bashkim familjar, duhet të plotësohen disa kushte.

Strehimi juaj dhe të ardhurat tuaja duhet të plotësojnë disa kritere.

➔ NDIHMAT PËR STREHIM (NËN KUSHTE)

- Ndhima për strehim: të paguara nga CAF.
- Fondi i Solidaritetit për Strehimin (FSH): pranë Këshillit të departamentit (ndihma për qira, kaucion ...).
- Nëse keni probleme me strehimin tuaj të tanishëm: kontakti Shoqatën e Departamentit të Informacionit të Strehimit (ADIL).
- Nëse jeni viktimë e dhunës: raportoni tek një asistent social (Këshilli të departamentit, CCAS) ose në një shoqatë të specializuar dhe më pas tek qiradhënësi publik për të marrë strehim në « Kontigjentin Prefectoral ».

KONTAKTE TË DOBISHME

Agence départementale d'information sur le logement (ADIL) : 02 32 24 06 66

Caisse d'Allocations Familiales (CAF) : 08 10 25 27 10

Conseil Départemental de l'Eure : 02 32 31 50 50

Direction Départementale de la Cohésion Sociale (DDCS) : 02 32 24 86 01

Association ADAEA Services la Pause : 02 32 33 52 76

PUNËSIMI

DHE TRAJNIMI



profesional dhe të ardhurat e të cilave nuk i kalojnë kufijtë e caktuar.

Ju duhet të dërgoni një kërkesë për një bonus të aktivitetit në faqen e internetit të caf.fr. Ju mund të ndihmoheni nga asistentët socialë të Këshillit të departamentit ose të Fondit të ndihmës familjare (CAF).

➔ PËR TË PUNUAR DHE TRAJNUAR NË FRANCË

Duhet të jeni në një situatë të rregullt dhe të keni titullin që ju autorizon të punoni. Për t'ju ndihmuar të gjeni një punë ose kërkonti një trajnim, mund të kontaktoni Pôle Emploi ose Mission Locale.

Për të përfutur nga shërbimet e Pôle Emploi, duhet të regjistrohemi si punëkërkuar në faqen e internetit: www.pole-emploi.fr. Nëse keni punuar disa muaj në Francë dhe numri i orëve të punës është i mjaftueshëm, ju mund të keni të drejtën e përfitimit të papunësisë. Ju duhet pastaj të aplikoni në Pôle Emploi i cili do të llogarit të drejtat tuaja.

➔ MISSIONET LOKALE PËR TË RINJTË

Mission locale është një hapësirë e ndërhyrjes që i shërben të rinjve prej 16/25 vjet. Çdo i ri i mirëpritur përfiton nga një ndjekje të personalizuar në kuadër të procedurave të tyre. Strukturat e mirëpritjes duhet të japin përgjigje për pyetjet e punësitit dhe trajnimit, por edhe për strehimin ose shëndetin.

➔ BONUSI I AKTIVITETIT

Bonusi i aktivitetit është një përfitim social që synon të plotësojë të ardhurat e punonjësve dhe të vetëpunësuarve me burime modeste. Ai paguhet nga CAF (ose MSA për fermerët dhe punonjësit bujqësorë). Bonusi i aktivitetit është i dedikuar për njerëzit që janë të angazhuar në një aktivitet

➔ BËNI MIRËNJOHJEN E DIPLOMAVE TUAJA

Nëse dëshironi të bëni mirënjohjen e diplomës tuaj që e keni marrë në një shtet jashtë Francës, ju duhet të shkoni në internet faqen e CIEP (Qendra Ndërkombëtare për Studime Pedagogjike), në rubrikën ENIC-NARIC, e cila jep dëshmi të krahasueshmërisë së diplomave. Kjo procedurë nuk është falas. Kjo certifikatë e lëshuar nga qendra ENIC-NARIC mund t'i paraqitet një punëdhënësi, një administratë që organizon një konkurs ose një institucion trajnimi.

➔ TRAJNIMI I GJUHËS

Për të mësuar frëngjisht, mund të merrni kurs: të aplikoni në sallën e komunës e komunës, qendrat socio-kulturore, shoqatat, qendrat shëndetësore, OFIL.

➔ LEJE PËR VOZITJE

Nëse jeni vendosur kohëve të fundit në Francë dhe keni një leje për vozitje joeuropiane, duhet ta shkëmbeni atë me një leje për vozitje franceze për të vazhduar të vozitni. Në varësi të shtetësisë tuaj, duhet të dorëzoni kërkesën tuaj për shkëmbim brenda një afati të caktuar. Nëse plotësoni kushtet për shkëmbim, ju lëshohet një patentë franceze. Për të shkëmbyer lejen tuaj për vozitje, ju duhet të kontaktoni prefekturën e departamentit tuaj.

Pôle emploi 39 49 ou www.pole-emploi.fr
Conseil Départemental de l'Eure : 02 32 31 50 50
Caisse d'allocations familiales (CAF) : 08 10 25 27 10
Office français de l'immigration et de l'intégration (OFII) : 02 32 18 09 94

Missions locales :
Pays d'Evreux et Eure Sud : 02 32 39 77 04
Vernon Sein Vexin : 02 32 51 50 65
Louviers Val De Reuil Andelle : 02 32 59 76 80
Ouest Eure Bernay : 02 32 43 36 80
Ouest Eure Pont-Audemer : 02 32 41 16 63 - 02 32 23 10 25

KONTAKTE TË DOBISHME



Udhëzues i të drejtave për gratë e juaja që arrijnë në Francë

Adresse de correspondance unique
Accueil Service - CS 50977 - 27007 EVREUX

ACCUEIL SERVICE

Direction Administration

3 rue du Dr Roux - Evreux

Tél : 02 32 26 73 53

Fax : 02 32 67 88 15

siège@accueilservice.fr

PLATEFORME SANTÉ SOCIALE

Tél : 02 77 02 07 25

LA PASSAGÈRE AU FÉMININ

8 place Alfred de Musset - Evreux

Tél : 02 32 23 01 78

lapassagere.aufeminin@accueilservice.fr

09h00 - 13h00 / 14h00 - 16h30

LA PASSAGÈRE

FEMMES VICTIMES DE VIOLENCES

8 place Alfred de Musset - Evreux

Tél : 02 32 23 01 78

lapassagere.fvv@accueilservice.fr

09h00 - 13h00 / 14h00 - 16h30

CAO DIFFUS

Evreux / Gaillon / Louviers

Tél : 06 43 46 32 37

cao@accueilservice.fr

LA PASSAGÈRE VERNON

14 rue de la renaissance - Vernon

Tél : 02 32 54 07 99

lapassagere.vernon@accueilservice.fr

8h30 - 13h00 / 14h00 - 16h30

LA PASSAGÈRE MARAUDE

8 place Alfred de Musset - Evreux

Tél : 02 32 23 76 40

lapassagere.maraude@accueilservice.fr

13h00 - 23h00

LA PASSAGÈRE EVREUX

84 avenue Foch - Evreux

Tél : 02 32 32 76 70

Fax : 02 32 37 51 40

lapassagere.evreux@accueilservice.fr

08h30 - 12h30 / 14h00 - 16h30